
	<p><b>Republika e Kosovës</b>          Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p><b>Komuna e Prishtinës</b>          Opština Priština –Municipality of Prishtina</p>	<p style="text-align: center;">PRISHTINA</p> 
---	---	--

Në bazë të nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2017, për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-155023/19 dt. 02.07.2019, të investitorit **Ramadan Mustafa për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërrimin e hapësirës banesore në hapësirë afariste, në Lagjen “Dardania” Bll. 9, Nr. 21, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datën 22.07.2019 lëshon këtë:**

## C E R T I F I K A T Ë E P Ë R D O R I M I T

**I. I LËSHOHET Certifikata e përdorimit investitorit-pronarit Ramadan Mustafa, sipas kërkesës 05 Nr.391/02-155023/19 dt. 02.07.2019, për përdorimin e ndërtesës të shndërruar nga hapësira banesore në hapësirë afariste sipas Vendimit 05 nr.351/02-03131411/17 dt. 21.03.2018 për lejimin e ndërrimit të destinimit përdorimit të hapësirës, e evidentuar në certifikatën e njësisë kadastrale O-71914059-07230-0-227-0-2-0, Zona Kadastrale Prishtinë, Lagja “Dardania, Bll. 9, nr. 21”, Prishtinë.**

**II. Ndërtesa, mund të përdoret, sipas destinimit të përcaktuar në pikën I. të Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-0313411/17 dt. 21.03.2018, dokumentacionit ndërtimor dhe Raportit të Inspektimit Final, nga Inspekcioni i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës.**

**III. Ndërtesa mund të përdoret nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate.**

**IV. Kjo Certifikatë shërben për regjistrimin e ndërtesës në regjistrin kadastral të përshkruar në pikën I. të këtij vendimi.**

## A r s y e t i m

Investitori-pronari Ramadan Mustafa, në Prishtinë, më kërkesën me 05 Nr. 391/02-155023/19 dt. 02.07.2019, i është drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për hapësirën e shndërruar nga banim në hapësirë afariste, në lokacionin e përshkruar si në pikën I. të dispozitivit të kësaj certificate.

Me kërkesë, investitori ka prezantuar:

- Vendimin nr. 05 Nr. 351/02-0313411/17 dt. 21.03.2018 për lejimin e ndërrimit të hapësirës banesore në hapësirë afariste të ndërtesës, e evidentuar në certifikatën e njësisë kadastrale O-71914059-07230-0-227-0-2-0, Zona Kadastrale Prishtinë, Lagja “Dardania, Bll. 9 nr. 21”, Prishtinë, me investitor Ramadan Mustafa nga Prishtina.

- Aktvendimin numër 05 Nr. 351/02-0313411 dt. 06.03.2018, mbi caktimin e taksës Administrative për lejen e ndërrimit të destinimit dhe tarifën për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës.
- Dëshmi mbi pagesën e taksës administrative për leje të ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës.
- Vendimin numër 05 Nr. 354/03-0033640 dt. 12.03.2018, për lejimin e rrënimin të aneksit të ndërtuar në certifikatën e njësisë kadastrale O-71914059-07230-0-227-0-2-0, Zona Kadastrale Prishtinë, i cili vendim edhe është zbatuar.
- Raportin e mbikëqyrjes profesionale si dhe raportin e udhëheqësit të punishtes, Emin Dragusha, IDN. udhëheqës i vend ndërtimit, dhe njëkohësisht mbikëqyrës për punët e realizuar gjatë shndërrimit të hapësirës.
- Protokollet e miratuara për të gjitha fazat e ndërtimit,
- Atestet e materialeve dhe rezultatet e testimeve,
- Fotografi gjatë procesit të ndërtimit,
- Kopjet e diplomave të inxhinierëve mbikëqyrës të objektit,

Njëkohësisht nga Drejtoria e Inspektionit-Sektorit i Ndërtimit përmes shkresës-Akt përcjellës nr. 09 Nr.391/02-8258/19 dt. 02.04.2019 ka arritur në Drejtori: Formulari i Inspektimit Final sipas UA. 05/2017 i plotësuar nga Drejtoria përkatëse, Raporti Final i inspektorëve, njoftim për punët e kryera në objekt si dhe foto të objektit të realizuar.

Drejtorja e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, konkretisht Raportin e Komisionit të Inspektimit Final të Inspektionit të ndërtimit të ndërtesës dhe pas dorëzimit të dokumentacionit nga ana e investitorit, përmes kërkesës 05 Nr. 391/02-155023/19 dt. 02.12.2019, ka konstatuar se:

Në raportin përfundimtar të inxhinierit mbikëqyrës fazave të ndërtesës si dhe matjeve gjeodezike, konstatohet se ndërtesa është realizuar në përputhshmëri të plotë me Ligin e Ndërtimit Nr. 04/L-110, projektin kryesor, Lejen e ndërrimit të destinimit 05 Nr.351/02-0313411/17 dt. 20.12.2016. Po ashtu theksohet se punët janë zhvilluar në harmoni me projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht hapësira banuese e shndërruar në hapësirë afariste, mund të përdoret.

Në Raportin e Inspektimit final të lëshuar nga Drejtoria e Inspektionit-Sektorit i Ndërtimit, është konstatuar se të gjitha punimet në objekt janë të përfunduara. Po ashtu edhe kërkesat që dalin nga Ligji për Ndërtim Nr.04/L-110, neni 27 janë të aprovuara nga ana e Inspektionit të Ndërtimit.

**Kërkesat e Vendimit 05 Nr. 351/02-0313411/17 të datës 21.03.2018 janë zbatuar,**

**Të gjitha mbetjet janë larguar nga vendi i ndërtimit dhe janë dërguar në një vend adekuat për deponimin e mbeturinave,**

**Masat për kursim të energjisë janë ndërmarrë.**

Kjo drejtori, bazuar në raportet e prezantuara dhe konstatimet e lartcekura, vendosi që hapësira banuese e shndërruar në hapësirë afariste, mund të përdoret/shfrytëzohet, gjegjësisht të lëshojë certifikatën e përdorimit për këtë ndërtesë.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

**Udhëzimi juridik:** Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPH-ja.

**I dorëzohet:** Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,  
05 NR. 391/02-155023/19 DT. 22.07.2019**

Zyrtari:

Berim Osmanaj



U.D. Udhëheqëse e sektorit:

Mimoza Berisha Prestreshi

